



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:279378
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640219

Ac.nr.10324/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.B nga P....., të cilin me autorizim e përfaqëson A.S, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit G.B nga P....., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.B, avokat në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1441/14 i datës 07.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit E.B nga P....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1441/14 i datës 07.09.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.1441/14 i datës 07.09.2021, ka vendosur si në vijim: *“I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit E.B nga P....., me të cilën ka kërkuar të detyrohet i padituri G.B nga P....., që për shkak të moslirimit nga taksat doganore për veturën të cilën e ka marrë në kompensim nga i padituri, ti paguaj paditësit shumën në lartësi prej 3.785 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare. II. Detyrohet paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës ti paguaj të*

paditurit shumën në lartësi prej 509,60 euro në afat prej 115 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.”

Kundër këtij aktgjykimi paditësi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa, të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në shkallën e parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ankesa i është dërguar të paditurit për të dhënë përgjigje në ankesë, por i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 14.05.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurit për kompensim dëmi në lartësi prej 3.785 Euro, e më gjerësisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1441/14 i datës 07.09.2021, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë me administrimin dhe vlerësimin e të gjitha provave të palëve ndërgjyqëse, që gjenden në shkresat e lëndës, e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pathemeltë, për faktin se nuk ka qenë kontestuese se mes palëve ndërgjyqëse është lidhur parakontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë e nënshkruar me dt. 23.04.2012, poashtu nuk ishte kontestues fakti se palët kontraktuese këtu ndërgjyqësit kanë arritur marrëveshje për çmimin e banesës, me ç`rast 10.500 Euro, i padituri ia ka paguar paditësit të gatshme dhe për pjesën tjetër të borxhit ia ka dhënë si kompensim një veturë të tipit BMW X5, ndërsa kontestuese mes ndërgjyqësve është detyrimi i blerësit të banesës, tani të paditurit për pagesën e taksave doganore të veturës, e cila i është dhënë si kompensim shitësit të banesës, ku paditësi pretendon se ky detyrim sipas parakontratës duhet ta paguajë i padituri, ndërsa i padituri pretendon se nuk ka ndonjë obligim ndaj paditësit, sepse i njëjti nuk ka garantuar lirimin nga taksat doganore, para muajit nëntor të vitit 2013. Sipas parakontratës së dt. 23.04.2012, e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse, në nenin 2 të saj, në pjesën ku parashihet obligimi i të paditurit ceket se: “blerësi i banesës i garanton shitësit të banesës për dokumentacionin e veturës dhe për gjendjen teknike dhe obligohet që do ta regjistroj veturën e shitësit të banesës deri në momentin e bartjes në pronësi të shitësit të banesës”, ndërsa me tej thuhet se: “Blerësi i banesës e garanton shitësin e banesës se vetura do të jetë e liruar nga pagesa e taksës doganore pas muajit nëntor të vitit 2013. Pas kësaj periudhe, blerësi i banesës do ta bartë pronësinë mbi veturën tek shitësi i banesës pa kompensim”, ku në këtë rast palët ndërgjyqëse kishin përcaktuar me parakontratë një kusht i cili nuk ishte i lejueshëm, andaj si i tillë është inekzistent dhe për këtë

arsye nuk është krijuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit që i njëjti të kompensohet në shumën e kërkuar.

Nga provat e paraqitura nga paditësi dokumenti unik doganor nr.ref. 515-121512, vërtetohet se me dt. 29.08.2012 paditësi e kishte bartë pronësinë e automjetit nga ish pronari i saj i mëparshëm, ku taksa doganore është vlerësuar në shumë prej 3.762.60 Euro, ndërsa nga fletëdeponimi i lëshuar nga NLB P..... në F..... i dt. 29.08.2012 dhe urdhërpagesa e të njëjtës datë, është vërtetuar se paditësi në emër të taksës doganore për automjetin e lartcekur i kishte deponuar Doganës së Kosovës shumën prej 3.762 Euro dhe me këtë e ka bartur pronësinë e automjetit nga personi i tretë në emër të tij. Poashtu nga certifikata e regjistrimit të automjetit e dt. 10.11.2011, është vërtetuar se automjeti i cili i është dhënë shitësit për një pjesë të çmimit të banesës nga ana e blerësit ishte në pronësi të personit të tretë A.B nga fsh. T....., ku në pjesën e fundit të kësaj certifikate është shënuar se lirohet nga dogana, nuk mund të shitet, huazohet dhe tjetërsohet.

Nga dëgjimi i paditësit në cilësi të palës gjykata vërtetoi faktin se paditësi nuk e ka pritur të paditurin për bartjen e automjetit deri në nëntor të vitit 2013, por edhe pse nuk e ka pritur afatin e dhënë nga i padituri kinse për lehtësimin e taksës doganore, gjykata gjeti se vetëm invalidët e luftës lirohen nga taksat doganore, por jo edhe personat e tretë, ndërsa nga dëgjimi i të paditurit në cilësi të palës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi me rastin e lidhjes së parakontratës ka qenë në dijeni se vetura që i është dhënë si pjesë për kompensim për blerjen e banesës, ishte e regjistruar në emër të një invalidi të luftës dhe se është dashur ta mbajë ashtu deri në nëntor të vitit 2013, ndërsa paditësi nuk e ka pritur këtë afat, por para këtij afati e ka bartur veturën në pronësi të tij. Gjykata i vlerësoi pretendimet e paditësit se me veprimet e të paditurit për një premtim se do të lirohej nga taksa doganore, është vënë në mashtrim dhe lajthim, por këto pretendime nuk janë argumentuar me asnjë provë, se me rastin e lidhjes së parakontratës kishte pasur të metat e vullnetit, ndërsa nga ana tjetër lirimin nga taksat doganore e ka gëzuar vetëm pronari i veturës me kusht që vetëm ai personalisht ta përdor, por jo edhe personat tjerë.

Andaj, gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit, konform nenit 28, 46, 47, 51, 52 të LMD-së e lidhur me nenin 7 dhe 319 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës se vendosjes të cilat i pranon si të rregullta edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktgjykimi nuk është

i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur për pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me refuzimin kërkesëpadisë së paditësit, i cili refuzim është në përputhje me provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës.

Pretendimet e ankuesit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, ku gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit, ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me refuzimin e kërkesëpadisë. Në rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, duke vlerësuar se paditësi e ka regjistruar veturën para afatit të cekur me dispozitën e nenit 2 të parakontratës, por duke pasur parasysh se lirimi nga taksat doganore të veturës i referohej vetëm pronarit të automjetit dhe se palët ndërgjyqëse me apo pa dijeninë e tyre, për ekzistimin e kësaj të drejte, kishin përcaktuar kusht në parakontratë për lirimin e paditësit nga taksat doganore pas afatit të caktuar në parakontratë, por që edhe sikur të kalonte afati sipas parakontratës, lirimi nga taksat doganore për paditësin nuk do të ndodhte, për arsye se lirimi nga taksat doganore i referohej vetëm pronarit të automjetit, ku sipas nenit 46 të LMD-së (1978), i cili ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil mes palëve ndërgjyqëse, është paraparë *“Detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, bërja, mosbërja ose durimi, ai duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar respektivisht i caktueshëm”*, ndërsa në rastin konkret lirimi nga taksa doganore e veturës të cilën e kishte marrë paditësi si kompensim nga i padituri për pjesën e çmimit të banesës, që është paraparë si kusht me parakontratë, është i palejueshëm, që bie në kundërshtim me dokumentacionin përkatës të veturës, konkretisht me certifikatën e regjistrimit të automjetit të dt. 10.11.2011, ku në faqen e fundit është ndalesa, ku ceket se lirohet nga dogana, nuk mund të shitet, huazohet dhe tjetërsohet, e që lirimi nga dogana i përket personit të caktuar në emër të të cilit ishte e regjistruar vetura. Sipas nenit 47 të LMD-së, parashihet se *“Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet kontrata është nule”*, nga çka rezulton e marrëveshja e palëve për lirim nga taksat doganore, është një e drejtë inekzistente dhe nuk mund të prodhojë efekt juridik, ngase pala e paditur nuk mund të detyrohet ta kompensojë paditësin për një detyrim të pamundur, gjë që parashihet edhe me dispozitat e nenit 51 dhe 52 të LMD-së, se kur baza juridike është e palejueshme ka për pasojë nulitetin e kontratës.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditësit e i njëjti është mashtruar nga i padituri se do të lirohet nga taksat doganore për automjetin i cili iu është dhënë paditësit nga i padituri, si pjesë e çmimit të banesës, e që një gjë të tillë e kanë paraparë edhe me parakontratë, por që nuk ka ofruar asnjë provë që do të vërtetonte të metat e vullnetit. Në bazë të nenit 7.1 të LPK-së, parashihet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe sipas nenit

319.1 të LPK-së parashihet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, e që në rastin konkret paditësi nuk ka arritur të provojë se i padituri e ka mashtruar apo e ka vënë në lajthim paditësin, ngase edhe nga provat e administruara dhe nga vetë deklarimi i palëve në cilësi të palës, është vërtetuar se parakontrata është lidhur me vullnetin e të dy palëve, të cilët janë marrë vesh për kushtet e saj, si dhe për dispozitën kontestuese lidhur me lirimin nga taksat doganore të veturës që kishte marr si kompensim paditësi, ku sipas nenit 28 të LMD-së, parashihet se *“Vullneti për ta lidhur kontratën mund të deklarohet me fjalë, me shenjat e zakonshme ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij. Deklarimi i vullnetit duhet të bëhet lirisht dhe seriozisht”*, e që në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar mungesa e vullnetit të paditësit lidhur me dispozitën kontestuese të parakontratës.

Gjykata e Apelit vlerëson se mbi gjendjen e vërtetuar faktike, në mënyrë të drejtë dhe të plotë është zbatuar drejtë edhe e drejta materiale, për arsye se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve i rregullojnë lirisht raportet e tyre kontraktuale, por nuk mund ti rregullojnë në kundërshtim me parimet e përcaktuara dhe dispozitat e detyrueshme, e që në rastin konkret, edhe gjykata ankimore vlerëson se lirimin nga taksat doganore e ka gëzuar vetëm pronari i veturës personalisht, me kusht që ai personalisht ta përdor veturën, por këtë të drejtë nuk e kanë gëzuar personat tjerë.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në përputhje me veprimet e ndërmarra procedurale dhe në mbështetje në dispozitën e nenit 452 të LPK-së, të cilat gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar në vendimin e saj.

Gjykata e Apelit mori për bazë edhe pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk ishin të themelta dhe të cilat nuk ndikuan që të vendoset ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10324/21, me datë 25.04.2024

Kryetare e kolegjit:
Nora Bllaca-Dula,d.v.